



Pranuar / Dorezuar Punëdhënësi/Pranuesi Received/Delivered	17 - 10 2023	3 viti god year	
Organ /Njësia Organ /Jedinstvo Org./Unit	Hr. Prot Bil. Prot Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicitna Quantity
SKPMESHCK	6563/2023		112



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic o Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD OR THE CIVIL SERVICE O KOSOVA

A.nr.1124/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtar, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1124/2023 të datës 29.08.2023 të parashtruar nga ankuesja të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Avokati kundër organit të punësimit, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike "Kërkese nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 17.10.2023 mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.1124/2023 të datës 29.08.2023 të parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja, e punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati më datë 29.08.2023 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 5844/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër reference Nr.Ref.263/2023, të datës 31.07.2023 për sistemim të përhershëm pas përfundimit të mandatit të nxjerr nga Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Në proces të shqyrtimit të ankesës nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16.10.2023, përfaqësuesi i autorizuar përmes shkresës së dërguar në e-mailin zyrtar ankesa.kpmshck@rks-gov.net e cila është protokolluar me numër të protokollit 6555/2023, ku me pëlqimin e ankueses e ka tërhequr ankesën me numër A.nr.1124/2023 të datës 29.08.2023, me

arsyetimin se tërheqja e kësaj ankese rrjedhë se me Vendimin me numër reference Nr.ref.355/2023 të datës 11.10.2023 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ankuesja është sistemuar në pozitën, „Udhëheqëse e Divizionit për Politika Konsullore” në Departamentin për Çështje Konsullore të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Kolegji i Këshillit duke marr për bazë kërkesën me numër të protokollit 6555/2023 të përfaqësuesit të autorizuar të ankueses për tërheqje nga ankesa, konstatoi plotësimin e kushtit ligjor për përfundimin e procedimit administrativ, siç parashihet me dispozitat e nenit 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë”, dhe si rrjedhojë në mbështetje të nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi për përfundimin e procedimit administrative të filluar sipas ankesës me numër A.nr.1124/2023 të datës 29.08.2023 të Lumturije Lipoveci, si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e Kryetares së Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi..

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1124/2023.

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore - GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Përfaqësuesit të ankueses
- Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.